MBI AUDITIMIN E USHTRUAR NË BASHKINË VORË

Raporti Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në Bashkinë Vorë me objekt: "Mbi Vlerësimin e aktivitetit ekonomiko-financiar, procedurat e shqyrtimit dhe miratimit të studimeve urbanistike, shesheve e lejeve të ndërtimit, lejeve te shfrytëzimit, administrimit të aseteve, dhënien me qira të objekteve pronë publike, funksionimi i Policisë Bashkiake, vlerësimi i auditit të brendshëm, etj." dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 38, datë 21.3.2012.
Bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23.12.1997 "Për Kontrollin e Lartë të Shtetit", ndryshuar me ligjin nr. 8599, datë 01.06.2000, me shkresën nr. 377/5, datë 21.3.2012, dërguar **z. Fiqiri ISMAILI,** Kryetar i Bashkisë, krahas Raportit Përfundimtar të Auditimit, Kontrolli i Lartë i Shtetit i ka rekomanduar dhe kërkuar zbatimin e masave të mëposhtme:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Të merren masa, për aktivet e qëndrueshme të patrupëzuara si: Llogaria 210 "Toka, troje, terrene" me vlerë 62,328,026 lekë; Llogaria 212 "Ndërtime e konstruksione" me vlerë 187.727.138 lekë; Llogaria 213 "Rrugë, mjete, vepra ujore" me vlerë 1,237,893,092 lekë; Llogaria 214 "Instalime, makineri pajisje e vegla pune" me vlerë 7,762,998 lekë, të hapen kartela për çdo aktiv ku të pasqyrohen origjina e këtyre mjeteve, viti i krijimit të tyre, vlera fillestare, përqindja e amortizimit (për ato që llogaritet amortizim), etj.

Menjëherë

2. Të merren, masa që të bëhen hyrje në magazinë e të kontabilizohen në kontabilitet vlerat prej 5,159,240 lekë e 6 studimeve e projektime të paguara nga Bashkia në vitet 2010 e 2011.

Menjëherë

3. Të merren masa, që në të gjitha rastet në dosjet e biznesit të vogël të administrohet Vendimi i QKR, në zbatim të neneve 75, 77 dhe 78 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit".

Menjëherë

4. Të merren masa, nga Sektori i Tatimeve, që të bëjë planifikimin real të taksave e tarifave vendore, bazuar në të dhënat, që disponon Bashkia, duke i programuar ato analitikisht në mënyrë, që niveli i planifikimit të tyre të vijë në rritje nga viti në vit dhe të jetë sa më real, si p.sh. për taksën mbi tokën bujqësore.

Vazhdimisht

5. Të merren masa, që kontratat e lidhura me subjektet për vendosjen e reklama në territorin e Bashkisë detyrimisht të shoqërohen me dokumentacion plotësues për të vërtetuar sipërfaqen e tatuar, planimetritë e skicat të jenë hartuara nga një organ i licencuar për këtë qëllim dhe të konfirmuara nga Zyra e Urbanistikës në Bashki.

Deri në datë 30.03.2012

6. Të merren masa, që në fund të çdo viti financiar detyrimet e pa shlyera nga tatim taksat të regjistrohen në kontabilitetin e Bashkisë për ndjekje dhe arkëtim.

Vazhdimisht

7. Të merren masa, që Drejtoria e Urbanistikës (Sekretaria Teknike) të mos paraqitë për shqyrtim e miratim në KRRT-në e Bashkisë:

a. leje të destinacionit të sheshit të ndërtimit dhe kondicioneve urbane të tij dhe leje ndërtimi, pa disponuar më parë një studim urbanistik rajonal e mjedisor, dhe projektet e ndryshme si projektin e plote te ngrohjes, projekti Elektrik, projekti i MKZ, projekti Hidraulik.

b. leje të destinacionit të sheshit të ndërtimit dhe kondicioneve urbane të tij dhe leje ndërtimi, pa shqyrtuar dhe miratuar më parë në Këshillin Teknik dhe KRRT-në, studimin urbanistik pjesor të hartuara nga struktura të licencuara.

c. leje shfrytëzimi për objekte të ndryshme ndërtimi, pa u paraqitur nga subjekti ndërtues dokumentacioni i plotë tekniko ligjor, si dhe konfirmimi nga Dega e Tatimeve i situacionit përfundimtar.

Vazhdimisht

8. Të merren masa, që anëtarët e KRRT-së në ç'do mbledhje të saj të deklarojnë konfliktin e interesit.

Vazhdimisht

9. Të merren masa, për kontabilizimin në kontabilitet dhe arkëtimin e shumës prej 3,491,684 lekë, (sipas tabelës bashkëlidhur) taksë e ndikimit në infrastrukturë nga investimet publike, shumë e cila përbënë të ardhura të munguar në buxhetin e Bashkisë, me destinacion të përcaktuar, për realizimin e studimeve urbanistike.

Deri në datë 30.06.2012

10. Autoriteti kontraktor të marrë masat, që për çdo tender të caktoi zyrtarisht struktura të specializuar për specifikimet teknike si dhe të bëjë ndarjet e detyrave për secilin nëpunës apo zyrtar të njësive të prokurimeve.

Vazhdimisht

11. Njësitë e Prokurimit (përgatitësit e dokumenteve të tenderave) të mbajnë procesverbale dhe dokumentacione të plota për procedurat e kryera në përcaktimin e fituesit të kontratës, në mënyrë të tillë, që të lejojnë kontrollin e zbatimit të ligjit. Gjithashtu të mbahen procesverbale të vlerësimit të ofertave për të saktësuar nëse kryen veprimet aritmetikore si dhe llogaritjet e vlerave anomalish të ulët duke përfshirë treguesit e cilësuar në legjislacionin e prokurimeve publike në fuqi të ofertave ekonomike të paraqitur për konkurrim nga operatorët ekonomik pjesëmarrës në tendera

Vazhdimisht

12. Komisionet e Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e operatorëve ekonomik konkurrues pjesëmarrës nëpër tendera detyrimisht të zbatojnë me rigorozitet kriteret kualifikuese të veçanta (specifike) të vendosura e të miratuara nga njësitë e prokurimit, pa bërë asnjë lloj interpretimi të tyre.

Vazhdimisht

13. Njësia e Prokurimit Publik në përgatitjen e kërkesave të veçanta për kualifikim të miratoi kërkesa, që të kenë lidhje me kontratat objekt prokurimi, të jenë të kuptueshme e pa interpretime, por të nocioneve kalon/ngel si dhe të stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël e të mesëm. Gjithashtu për tenderat e punëve publike nuk duhet të kërkojë dokumente shtesë për vërtetimin e kryerjeve të punëve të ngjashme e të së njëjtës natyre si dhe disponimin e makinerive e aseteve përveç shtojcave respektive formularët nr. 7 dhe 8 të miratuar me DST.

Vazhdimisht

14. Autoriteti kontraktor të marrë masa, që në kontratat e lidhura në nenet për "dëmet e likuidueshme për vonesën në mbarimin e punimeve, furnizimeve dhe shërbimeve", të vendoset vetëm përqindja, që i korrespondon afatit kohorë: të dorëzimit të punimeve, të furnizimit me mallra apo të shërbimeve të kryera.

Vazhdimisht

B. <u>MASA DISIPLINORE</u>

1. Mbështetur në nenet 37 e 144 të ligjit nr. 7691, datë 12.07.1995 "Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë" të ndryshuar, si dhe kontratës të punës, Kryetari i Bashkisë Vorë, të fillojë procedurat për dhënien e masës disiplinore:

<u>"Vërejtje me paralajmërim për zgjidhjen e kontratës së punës".</u>

-[redacted] me detyrë Përgjegjës Sektori i Tatim Taksave, për shkeljet dhe mangësitë të konstatuara gjatë kontrollit në ushtrimin e detyrave të tij funksionale:

a- në kundërshtim me nenet 75, 77 dhe 78 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", si dhe të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", jo në të gjitha rastet në dosjet e biznesit të vogël administrohej Vendimi i QKR-së;

b-kontrata me subjektet reklamues nuk janë shoqëruar; dokumentacion plotësues për të vërtetuar sipërfaqen e tatuar, nuk ka një listë të shoqëruar me planimetri e skica nga një organ i licencuar për këtë qëllim dhe e konfirmuar nga zyra e urbanistikës në Bashki, si dhe nuk ka specifikime për tabelat deri në 18 m^2 apo mbi 18 m^2. Dokumentacion ky i domosdoshëm për të vërtetuar sipërfaqen e tabelave reklamuese;

c-Në fund të çdo viti financiar nuk janë kërkuar për tu regjistruar në kontabilitetin e Bashkisë detyrimet e pa shlyera nga tatim taksat për ndjekje dhe arkëtim, kjo mbështetur në: ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore", me ndryshimet, neni 27, "Mbajtja e Regjistrimeve", ligjin nr. 7776, datë 22.12. 1993 "Për Buxhetin Lokal", i ndryshuar, VKM nr. 783 datë 22.11.2006 "Për Përcaktimin e Standardeve dhe të Rregullave Kontabël", pika 2 "Dokumentet e Kontabilitetit", germa "c", pikat 2 e 3 "Rregullat e përgjithshme të mbajtjes së librave dhe dokumenteve të tjera të kontabilitetit".

<u>Shënim</u>: Auditimi u krye nga audituesit Artan Mirashi, Ymer Stafa, Jonel Nasto dhe Ervehe Çumani. Më tej u shqyrtua nga Kryeauditues i Departamentit Miranda Haxhia, Drejtori i Departamentit Pullumb Beqiraj, Drejtori i Drejtorisë Juridike dhe Kontrollit të Cilësisë Elvana Tivari, si dhe u verifikua si praktikë nga Drejtori i Përgjithshëm Robert Gjini.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT